



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/7  
Nr. \_\_\_\_\_/Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 556, datë 28.10.2025

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË  
KURRIKULËS BËRTHAMË DHE TË KURRIKULËS ME ZGJEDHJE, TË  
ARSIMIT TË MESËM TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Gjuhë shqipe”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Letërsi”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

5. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Histori”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
6. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjeografi”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Muzikë”, të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Art pamor”, të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Teatër”, të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Matematikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Fizikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Kimi”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Biologji”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë e huaj e dytë”, të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë dhe klasën e dymbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Programet mësimore të klasës së dhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
18. Programet mësimore të klasës së njëmbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
19. Programet mësimore të klasës së dymbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2028 – 2029.
20. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ORJANA OSMANI**



# PROGRAMI I LËNDËS “ART PAMOR” ARSIMI I MESËM I LARTË (ME ZGJEDHJE) KLASAT 10/11/12

FUSHA “ARTET”

Koordinator: Marina Topulli



## PËRMBAJTJA

<b>1</b>	<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
<b>2</b>	<b>QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS</b> .....	<b>6</b>
2.1	Objektivat e përgjithshme të lëndës.....	7
<b>3</b>	<b>PËRMBAJTJA E PROGRAMIT</b> .....	<b>8</b>
<b>4</b>	<b>KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E ARTIT PAMOR</b> .....	<b>11</b>
4.1	Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit .....	11
4.2	Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e artit pamor .....	17
4.3	Kompetencat e lëndës “Art pamor” dhe aftësitë e shekullit XXI që zhvillohen përmes saj .....	19
4.4	Kompetencat e lëndës së artit pamor dhe rezultatet e të nxënit.....	20
<b>5</b>	<b>PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT</b> .....	<b>25</b>
5.1	Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë .....	25
5.2	Përmbajtja e lëndës sipas tematikave dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre .....	26
5.2.1	Tematikat: Gjuha dhe komunikimi artistik – Teknika dhe procese artistike – Historia, arti dhe shoqëria .....	26
5.3	Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve). .....	34
<b>6</b>	<b>METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES</b> .....	<b>37</b>
6.1	Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e artit pamor. ....	37

6.2	Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e artit pamor .....	39
6.3	Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e artit pamor .....	40
7	VLERËSIMI I NXËNËSVE .....	41
7.1	Llojet e vlerësimit në lëndën e artit pamor .....	41
7.2	Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit në lëndën e artit pamor .....	43
7.3	Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënësve, RN-ve.....	43
8	BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE .....	45
8.1	Përdorimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale.....	46
9	REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT .....	47
a)	<i>Rekomandime për mësuesit</i> .....	47
b)	<i>Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm</i> .....	47
c)	<i>Rekomandime për prindërit</i> .....	48
d)	<i>Rekomandime për nxënësit</i> .....	48
10	NDRYSHIMET PËRMBAJTJESORE .....	49

## Përmbajtja e tabelave

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit .....	12
Tabela 2: Kompetencat e artit pamor dhe rezultatet e të nxënit .....	22
Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë .....	25
Tabela 5. Shembull i veprimtarive për përmbushjen e RN-ve.....	34
Tabela 6. Shembull për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve .....	44

## Përmbajtja e diagrameve

Diagrama 1. Përmbajtja e programi lëndor të artit pamor .....	9
Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së artit pamor.....	21
Diagrama 3. Shembull situatë të nxëni dhe lidhja me elementet e programit .....	36

## 1 HYRJE

Arti pamor është një nga lëndët artistike që përmban fusha e arteve në gjimnaz dhe, ashtu si të gjitha lëndët e tjera brenda fushës së arteve, luan një rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve të kësaj grup moshe duke u nxitur imagjinatën, zhvilluar ndjenjën e së bukurës dhe duke u mësuar atyre rrugët për të kuptuar botën dhe mjedisin që i rrethon. Ky program bën të mundur thellimin, zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të njohurive të artit pamor. Ashtu si programi i artit pamor në arsimin e mesëm të ulët edhe në arsimin e mesëm të lartë ky program ndërton dhe zhvillon në tri kompetenca: *krijimi artistik, realizimi i punimit dhe vlerësimi i veprave të artit.*

Arti pamor komunikon nëpërmjet gjuhës së simboleve, përmes të cilave nxënësit mësojnë të identifikojnë vlera estetike dhe njerëzore në vepra të ndryshme arti dhe të kuptojnë ndikimin e artit në shoqërinë njerëzore. Përmes kësaj lënde ata do të komunikojnë dhe do të zhvillojnë aftësitë e tyre artistike, jo vetëm përmes gjykimit estetik, arsytimit, mendimit kritik, por edhe përmes krijimit konkret në punë 2 -3 dimensionale. Krijimet e ndryshme, që do të realizohen përmes punës në klasë, do t'i motivojnë ata të përfshihen në mënyrë aktive në jetën artistike të shkollës, komunitetit dhe në rang vendi.

Kjo lëndë kërkon që përmes studimit të përmbajtjes, që ajo ofron, të arrihen qëllimet kryesore të lëndës duke dhënë kontributin e saj në zhvillimin personal të nxënësve, si dhe duke u dhënë mundësinë atyre të shohin vetveten si pjesë e shoqërisë dhe kontribues aktivë në të. Lënda ndihmon dhe në përgatitjen e nxënësve si qytetarë aktivë të një shoqërie evropiane.

## 2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

**Qëllimi i artit pamor** në arsimin e mesëm të lartë është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e kulturës pamore të nxënësve. Mësimi i artit pamor në klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë vijon të edukojë nxënësin nga pikëpamja estetike/artistike dhe pamore, duke i orientuar ata në mënyrë të saktë drejt kuptimit të vlerave estetike dhe veçorive të gjuhës së artit pamor, në njohjen me mjetet dhe teknikat e ndryshme artistike, me gjinitë dhe llojet e ndryshme të artit pamor, si dhe duke u njohur me zhvillimin historik të artit pamor në kontekste dhe kultura të ndryshme.

Lënda e artit pamor mundëson:

- vëzhgimin dhe vlerësimin e veprave të artit kombëtar si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore shqiptare, me qëllim ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, e njëkohësisht duke zhvilluar aftësitë e qëndrimit *estetik dhe vlerësimit kritik*.
- vëzhgimin dhe vlerësimin e artit pamor të periudhave të ndryshme historike sipas stilit, gjinive, gjuhës dhe teknikave artistike, duke zhvilluar *qëndrimin estetik dhe vlerësimin kritik*;
- zhvillimin e aftësive bashkëpunuese në krijimin e raporteve ndërmjet kulturave, duke ndërvepruar në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike;
- kuptimin e formave të ndryshme të veprimtarisë artistike duke zhvilluar aftësitë krijuese, individuale;
- zhvillimin e kompetencave të artit pamor për krijimin dhe realizimin e punëve të ndryshme artistike;
- pjesëmarrjen në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke vënë në shërbim të mjedisit ku jeton aftësitë dhe talentin e vet;
- dhënien e kontributit personal në veprimtaritë artistike në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

## 2.1 Objektivat e përgjithshme të lëndës

Objektivat e përgjithshme që synohen të arrihen në përfundim të klasës së dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë kërkon që nxënësit:


- Të zhvillojnë aftësitë krijuese, komunikuese, vlerësuese dhe të kuptojnë botën që i rrethon nëpërmjet artit pamor;
- Të përvetësojnë njohuritë themelore të artit pamor në lidhje me gjuhën dhe teknikat e artistike;
- Të formojnë kulturën pamore përmes njohjes së larmisë së shprehjes artistike mbështetur në shembujt më të rëndësishëm të traditave artistike kombëtare e botërore.
- Të zhvillojnë aftësitë për të vëzhguar, analizuar dhe vlerësuar vepra të ndryshme të artit;
- Të mësojnë të bashkëpunojnë në grup dhe të respektojnë e vlerësojnë kontributin e çdo anëtari për arritjen e qëllimit të përbashkët krijues;
- Të formojnë vetëdijen kulturore dhe ndjeshmërisë artistike që ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme estetike/artistike në jetën e përditshme;
- Të zhvillojnë aftësitë krijuese duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën vizuale, për të komunikuar mendimin e tyre për një audiencë të caktuar;
- Të zhvillojnë aftësitë analizuese dhe vlerësuese ndaj fenomeneve të ndryshme artistike/kulturore, ndaj veprave të artit, ndaj punës së tyre dhe ndaj punës së shokëve dhe shoqeve të klasës;
- Të formojnë qëndrimin pozitiv ndaj mësimit të artit pamor dhe përfshirjes në jetën kulturore;
- Të bëjnë lidhjen e artit pamor me lëndët e tjera në kurrikul dhe ta shohin artin si një mundësi karriere.

### 3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i artit pamor synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe, duke u mbështetur në situata të jetës reale dhe në kontekstin shkollor. Në thelb, ky program përqendrohet në edukimin dhe formimin kulturor të nxënësve si individë të aftë për të kuptuar, zbatuar dhe vlerësuar njohuritë e artit pamor në mënyrën e duhur dhe ndihmuese në zgjidhjen e situatave në jetën e tyre të përditshme. Programi i lëndës së artit pamor në arsimin e mesëm të lartë përmban:

- a) *Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënësve që zhvillohen nëpërmjet lëndës së artit pamor.* Lënda e artit pamor kontribuon drejtpërdrejt në ndërtimin e kompetencave kyçe si dhe aftësive të shekullit 21-të si: të menduarin kritik dhe zgjidhjen e problemeve, aftësitë qytetare, aftësitë digjitale etj. *Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së artit pamor.* Programi i artit pamor ndërthur njohuritë dhe aftësitë e saj me temat ndërkurrikulare si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; qytetaria aktive dhe sipërmarrja; shëndeti mendor e fizik dhe siguria; zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore; teknologjia, shoqëria dhe media duke i lidhur konceptet pamore me situata konkrete që nxënësit përballen në jetën e tyre.
- b) *Kompetencat e lëndës së artit pamor dhe rezultatet e të nxënësve.* Lënda e artit pamor synon të pajisë nxënësit me kompetenca që shkojnë përtej. Arti pamor nuk është vetëm një disiplinë artistike, por një mjet i fuqishëm për të zhvilluar aftësi kyçe të shekullit 21. Kjo lëndë e përgatit nxënësin për të qenë *krijues, bashkëpunues, komunikues efektiv dhe qytetar aktiv* në një botë në zhvillim të vazhdueshëm. Aftësitë kyçe të shekullit 21, janë një grup kompetencash që i ndihmojnë individët të jenë të suksesshëm në një botë që ndryshon me shpejtësi, të drejtuar nga teknologjia, informacioni dhe globalizimi. Lënda e artit pamor, në mënyrë të natyrshme, kontribuon fuqishëm në zhvillimin e këtyre aftësive.

Diagrama 1. Përmbajtja e programi lëndor të artit pamor



- a) *Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënësve.* Në këtë rubrikë përshkruhet koha e dedikuar (numri i orëve mësimore) të klasës së dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë për çdo tematikë, duke ofruar hapësirë për punë individuale, në grup etj; tematikat e lëndës dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre; njohuritë kryesore, aftësitë për secilën tematikë dhe qëndrimet që demonstroi nxënësi.
- b) *Metodologjia e mësimdhënies.* Në lëndën e artit pamor është e rëndësishme t'i kushtohet një vëmendje e madhe përdorimit të metodave interaktive, teknikave të menduarit kritik dhe krijues, bashkëpunimit në grup. Përshtatja e mësimimit për nxënësit me nevojat të veçanta dhe mbështetja e talenteve në lëndën e artit pamor nxit kuriozitetin për lëndën. Në këtë rubrikë do të ketë edhe disa shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve.
- c) *Vlerësimi i nxënësve është një tjetër rubrikë,* e cila përshkruan në mënyrë të përmbledhur llojet e vlerësimit të nxënësit, shembuj të instrumenteve të vlerësimit, vlerësimin si metodologji të nxënësve. Gjithashtu në këtë rubrikë do të ketë edhe shembuj të niveleve të arritjes së rezultateve të të nxënësve.
- d) *Burimet dhe materialet didaktike* që mund të përdoren në lëndën e artit pamor. Njohja me konceptet artistike, mjetet dhe teknikat dhe vepra të ndryshme të artit pamor të sjella nga burime të ndryshme dhe materiale didaktike të demonstruara me mjete konkrete.
- e) *Rekomandime për zbatimin e programit.* Në këtë rubrikë do të ketë disa rekomandime për përdoruesit e programit lëndor siç janë: nxënësit, mësuesit, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, prindërit.
- f) *Ndryshimet përmbajtjesore.* Në këtë rubrikë do të përshkruhen përditësimet kryesore në përmbajtjen lëndore.

## 4 KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA ARTIT PAMOR

### 4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës, sipas klasave të arsimit të mesëm të lartë. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive. Arti pamor nuk është vetëm një disiplinë artistike, por një mjet i fuqishëm për të zhvilluar aftësi kyçe të shekullit 21. Ajo e përgatit nxënësin për të qenë *krijues, bashkëpunues, komunikues efektiv dhe qytetar aktiv* në një botë në zhvillim të vazhdueshëm. Aftësitë kyçe të shekullit 21, janë një grup kompetencash që i ndihmojnë individët të jenë të suksesshëm në një botë që ndryshon me shpejtësi, të drejtuar nga teknologjia, informacioni dhe globalizimi. Lënda e artit pamor, në mënyrë të natyrshme, kontribuon fuqishëm në zhvillimin e këtyre aftësive.

- **Kreativiteti**, ku arti pamor inkurajon dhe nxit krijimtarinë përmes gjuhës artistike dhe teknikave të larmishme. Nxënësit mësojnë të shprehin veten në mënyrë unike dhe të zhvillojnë ide origjinale.
- **Bashkëpunimi**, ku arti pamor nxit nxënësit të punojnë në grup si p.sh: në projekte të përbashkëta. Kështu ju jepet mundësia që ata të punojnë në grup, të zhvillojnë hulumtimin aktiv dhe të ndajnë dhe kuptojnë përgjegjësitë.
- **Komunikimi**, ku arti pamor si një formë universale komunikimi – përçon emocione, mesazhe dhe histori. Gjithashtu, diskutimi mbi artin dhe kulturën ndihmon zhvillimin e të folurit dhe të shkruarit.
- **Mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve**, ku arti pamor inkurajon dhe nxit nxënësit në analizimin e veprave të artit dhe të fenomeneve apo objekteve kulturore, zhvillon aftësitë e vendimmarrjes gjatë krijimit dhe zgjidhja e sfidave tekniko-artistike ndihmojnë në zhvillimin e mendimit analitik.

- **Aftësitë teknologjike**, ku arti pamor inkurajon dhe nxit përdorimin e programeve të ndryshme krijuese, që ofrojnë mjete dhe mënyra novatore në krijim, gjurmimin dhe shpërndarjen e informacionit artistik duke zhvilluar aftësitë digjitale.
- **Ndërgjegjësimi global dhe kompetencat kulturore**, ku arti pamor jep mundësinë njohjen dhe kuptimin e kulturave të ndryshme në klasë. Mësimi i artit pamor i ndihmon nxënësit të jenë më të hapur dhe të kuptojnë diversitetin kulturor.
- **Aftësitë për mësim gjatë gjithë jetës**, ku arti pamor kërkon përkushtim, durim dhe disiplinë – vlera që ndihmojnë në formimin e një qëndrimi pozitiv ndaj të nxënës të vazhdueshëm.

*Kompetenca kuptohet sot si një ndërthurje e balancuar mes njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që mundësojnë nxënësin të përballë me situata reale dhe komplekse në mënyrë efektive dhe të pavarur. Qasja e mësimdhënies e bazuar në kompetenca e zhvendos fokusin nga përvetësimi pasiv i përmbajtjes lëndore (me mësuesin si qendër të procesit) drejt formimit të aftësive që ndihmojnë nxënësin të kuptojë, të zbatojë dhe të transferojë njohuritë në situata të reja dhe jetësore, duke u vendosur vetë nxënësi në qendër të procesit. Rezultatet e të nxënës për kompetencat kyçe që duhet të zhvillojë nxënësi në klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë në lëndën e artit pamor mund të përmbledhen si më poshtë:*

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<p><i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- komunikon në mënyrë efektive si dëgjues, folës, lexues dhe shkruer;</li> <li>- përshtat komunikimin me situatat dhe qëllimet e artit pamor;</li> <li>- kërkon, mbledh dhe përpunon informacione mbi artin pamor, përfaqësuesit dhe veprat artistike me mjete ndihmëse;</li> </ul>	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- fillon, ndjek dhe përfundon biseda të thjeshta për tema të ndryshme artistike dhe të kulturës;</li> <li>- përdor mjetet dhe angazhohet në komunikim joformal mbi artin pamor;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- formulon dhe shpreh argumente në gojë dhe shkrim ndaj artit pamor apo ngjarjeve të ndryshme kulturore;</li> <li>- merr pjesë në biseda për tema artistike apo kulturore;</li> <li>- transmeton saktë të dhënat artistike të mbledhura në forma të ndryshme;</li> <li>- prezanton projekte të artit pamor përmes komunikimit verbal dhe elektronik;</li> <li>- formulon analiza të thelluara mbi tekstet dhe mesazhet e veprave të artit;</li> <li>- shpreh opinion kritik dhe vlerësimin personal mbi vepra arti, artistë apo vende kulturore;</li> <li>- komunikon qartë në shkrim dhe me gojë gjatë prezantimeve artistike;</li> <li>- identifikon burime informacioni për orientim profesional dhe zhvillon një plan karriere .</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- merr pjesë në biseda me tema të ndryshme mbi artin pamor, duke bërë pyetje dhe dhënë përgjigje;</li> <li>- transmeton saktë informacion mbi artin pamor në formë të ndryshme;</li> <li>- prezanton një projekt me temë mbi artin pamor duke përdorur komunikimin verbal dhe elektronik;</li> <li>- përshkruan dhe vlerëson vepra arti ose elemente të kulturës në gjuhë të huaja;</li> <li>- komunikon vlerësimin personal për një vepër artistike në një gjuhë të dytë;</li> <li>- përdor gjuhën e huaj për të kërkuar, përshkruar ose prezantuar projekte artistike.</li> </ul>
<b>Kompetenca në STEM (matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri)</b>	<b>Kompetenca digjitale</b>
<p><i>Për të dëshmuar kompetencat në STEM nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton parime dhe procese artistike në jetën e përditshme, përfshirë aftësitë vëzhguese, analizuese, kërkuese, krijuese, etj.;</li> </ul>	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor programe digjitale që ofrojnë mundësi të ndryshme shprehëse për krijuar;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- aplikon njohuritë matematikore në krijime të ndryshme por edhe në strukturën e punimit artistik;</li> <li>- përdor instrumente ose pajisje digjitale për të krijuar;</li> <li>- lidh fenomene natyrore dhe teknologjike me artin pamor;</li> <li>- njeh karakteristikat e kërkimit artistik dhe komunikon përfundimet;</li> <li>- shfrytëzon burime të ndryshme për zhvillimin e ideve dhe projekteve;</li> <li>- parashtron pyetje dhe organizon mendimet për zgjidhjen e problemeve;</li> <li>- prezanton idetë për zhvillimin e aktiviteteve në artin pamor dhe i argumenton ato;</li> <li>- përdor informacionin për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve duke argumentuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- harton prezantime multimediale mbi histori, vepra arti, elemente kulturore apo artistë të veçantë;</li> <li>- menaxhon përmbajtje artistike në platformat online me etikë dhe kreativitet;</li> <li>- identifikon dhe zgjidh probleme artistike, duke përdorur teknologjinë dhe mjediset digjitale;</li> <li>- përdor inteligjencën artificiale për të analizuar dhe interpretuar të dhëna artistike apo dhe për të zgjidhur problem;</li> <li>- bashkëpunon me moshatarët duke përdorur teknologjinë për zgjidhjen e problemeve artistike;</li> <li>- përdor mendimin kritik për të planifikuar projekte të ndryshme artistike.</li> </ul>
<b>Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit</b>	<b>Kompetenca qytetare</b>
<p><i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillon stilin personal të të mësuarit përmes përvojave artistike;</li> <li>- planifikon objektiva për zhvillimin e vetëdijshëm artistik dhe emocional;</li> <li>- reflekton për rolin e artit pamor në rritjen e vetes dhe të të tjerëve;</li> </ul>	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- tregon solidaritet në zgjidhjen e problemeve në shkollë, komunitet e më gjerë;</li> <li>- vlerëson diversitetin kulturor me tolerancë dhe respekt;</li> <li>- demonstroi vlerat e të drejtave të njeriut, si respekti për dinjitetin personal dhe lufta kundër diskriminimit;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon dhe përmirëson përparësitë dhe dobësitë personale lidhur me artin pamor;</li> <li>- organizon, fokusohet në të nxënit, vendos qëllime dhe vlerëson punën e tij;</li> <li>- motivon dhe vlerëson veten, punon në mënyrë të pavarur dhe në grup në procese të ndryshme artistike;</li> <li>- shpreh dëshirë për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe bashkëpunon në mënyrë konstruktive;</li> <li>- analizon dhe zgjidh probleme emocionale dhe sociale, duke propozuar alternativa pozitive.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- inkuadrohet në veprimtari kulturore dhe artistike që i shërbejnë komunitetit;</li> <li>- identifikon dhe reflekton mbi çështje sociale përmes krijimit artistik;</li> <li>- merr pjesë në projekte që promovojnë kulturën kombëtare dhe dialogun ndërkulturor.</li> <li>- menaxhon dhe zgjidh konfliktet në mënyrë konstruktive dhe paanshme;</li> <li>- reagon ndaj shkeljeve të të drejtave të të tjerëve dhe diskuton pasojat e këtyre veprimeve.</li> </ul>
<b>Kompetenca e sipërmarrjes</b>	<b>Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore</b>
<p><i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor imagjinatën për procese krijuese dhe novatore në artin pamor;</li> <li>- planifikon projekte artistike dhe i organizon proceset deri në përfundim;</li> <li>- organizon ngjarje kulturore/artistike me përgjegjësi buxhetore dhe logjistike;</li> <li>- tregon leadership në ndarjen e roleve dhe në menaxhimin e burimeve artistike;</li> </ul>	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpreh dhe interpreton emocionet dhe idetë e tij me art dhe forma të tjera kulturore;</li> <li>- shpreh veten në media të ndryshme, duke përmirësuar kapacitetin personal;</li> <li>- identifikon mundësi për të shprehur vlera personale, sociale nëpërmjet arteve;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor aftësi kreative për të zhvilluar ide dhe projekte novatore;</li> <li>- punon në mënyrë të pavarur dhe bashkëpunon me të tjerët;</li> <li>- vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit;</li> <li>- ndërmerri aktivitete për zgjidhjen e problemeve shoqërore (ekspozita, fushata, etj.);</li> <li>- analizon pasojat e dëmtimit të mjedisit dhe organizon aktivitete për mbrojtjen e tij;</li> <li>- përdor materiale dhe teknologjinë për avancim në mësim dhe orientim në karrierë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- zbulon identitetin përmes analizës dhe krijimit artistik;</li> <li>- vlerëson trashëgiminë në artet pamore si pjesë e ndërtimit të një kulture personale dhe kolektive;</li> <li>- eksperimenton me forma të ndryshme artistike për të shprehur mendim artistik;</li> <li>- angazhohet në procese krijuese, si individualisht ashtu dhe kolektivisht.</li> </ul>
--	---

## 4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e artit pamor<sup>1</sup>

Integrimi i temave ndërkurrikulare me artin pamor në arsimin e mesëm të lartë u mundëson nxënësve të kuptojnë më thellë lidhjet ndërmjet artit pamor dhe jetës reale, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi analitike, mendim kritik, argumentim dhe zgjidhje problemesh. Këto tema përforcojnë përdorimin e njohurive pamore si mjet për interpretimin e të dhënave, planifikimin, marrjen e vendimeve dhe vlerësimin e situatave të ndryshme shoqërore, kulturore dhe artistike.

- › *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.* Arti pamor i ofron mundësinë nxënësit për zhvillimin e ndjenjës së *identitetit kombëtar, njohjes dhe respektit ndaj kulturave të ndryshme.* Përmes zhvillimit të kësaj teme lënda e artit pamor kërkon të zhvillojë ndjenjën e identitetit kombëtar përmes njohjes së historisë dhe veprave të artit shqiptar por edhe të elementeve të trashëgimisë kulturore materiale shqiptare. Nëpërmjet njohjes me trashëgiminë kulturore materiale të luajtshme si, objekte etnografike (objekte arkeologjike, veshjet, objekte të përdorimit të përditshëm, vegla muzikore, punime të ndryshme artizanale, etj.), trashëgiminë kulturore të paluajtshme ku bëjnë pjesë ndërtesat, qytetet muze dhe sitet arkeologjike, nxënësit rrisin krenarinë kombëtare. Gjithashtu arti pamor ofron mundësinë që nxënësi të njohë vepra artistë dhe elemente kulturore nga kultura të tjera gjë e cila kultivon edhe respektin për larminë kulturore dhe artistike. Kjo tematikë mundëson organizimin e aktiviteteve artistike dhe nxit krijimin në tema të tilla si: “Trashëgimia jonë kulturore”, “Java Ndërkulturore”, etj., nëpërmjet të cilave nxënësit kërkojnë, rrisin informacionin dhe ndajnë njohuritë.

---

<sup>1</sup> *Veprimtaritë praktike të zhvillimit të temave ndërkurrikulare mund të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë – art pamor.*

- › *Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.* Në këtë temë, arti pamor luan rol kyç sepse krijon mundësi që nxënësi të mësojë jo vetëm për artin, por edhe për rolin e tyre si qytetarë të angazhuar dhe krijues në komunitet. Duke qenë se arti pamor ka qenë gjithmonë një formë shprehjeje për çështje sociale, politike dhe komunitare, nxënësi analizon vepra arti dhe elemente kulturorë që përcjellin mesazhe të drejta qytetare, si: promovimi i paqes, të drejtat e njeriut, barazinë apo mbrojtjen e mjedisit etj. Nxënësi realizon krijime që përcojnë mesazhe sociale, duke u angazhuar në diskutime dhe reflektime mbi realitetin e tyre. Për realizimin e kësaj tematike mund të realizohen punime që përcjellin një mesazh, (p.sh. ndihmë për fëmijë në nevojë, kujdesi ndaj të moshuarve, kujdesi ndaj mjedisit, etj.). Ndërsa në lidhje me sipërmarrjen mund të trajtohen tema si: *si të menaxhosh hapjen e një ekspozite, krijim nëpërmjet riciklimit, etj.* Tema të tjera p.sh.: si funksionon shpërndarja e informacionin apo reklamimi i krijimit artistik – nga prodhimi i veprës së artit, marketingu, promovimi, deri te shitja, apo *roli i rrjeteve sociale* në zhvillimin e promovimit të një karriere artistike.
- › *Shëndeti mendor, fizik dhe siguria.* Arti pamor krijon mundësi të mira për të edukuar nxënësin por edhe duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien emocionale, fizike dhe sociale të tyre. Gjithashtu arti pamor luan një rol të rëndësishëm në jetën tonë të përditshme dhe shpesh përdoret për të reduktuar stresin, ankthin si dhe për të përmirësuar gjendjen shpirtërore. Nxënësi vëzhgon dhe analizon rreth një punimi ose fenomeni artistiko-kulturor që zhvillon ndjenjën e qetësisë dhe vetëdijes emocionale; krijon për të komunikuar mendimin dhe ndjesitë personale, që zhvillon ndjenjën e përqendrimit dhe të vetëbesimit; Gjithashtu, arti pamor është e lidhur ngushtë me **aktivitetin fizik**, sidomos përmes përdorimit të mjeteve dhe teknikave të ndryshme artistike. Ajo edukon nxënësin me sigurinë se si:
- të sillet dhe rregullat që duhet të ndjekë gjatë **aktivitetit artistik** si ai personal dhe i punës në grup (përdorimi i duhur i mjeteve, dhe ndarja e duhur e punës, etj.) kujdesi për veten, tjetrin dhe mjedisin, etj.).
  - të ruaj veten, të tjerët dhe mjedisin duke përdorur dhe menaxhuar në mënyrën e duhur mjetet dhe teknikat artistike (ruan veten dhe shokun nga mjete që duhen përdorur me kujdes, menaxhimin e tyre për të mos i shpërdoruar dhe për të mos ndotur mjedisin).
  - të diskutojë dhe ndajë nëpërmjet internetit krijimet e veta artistike duke ruajtur të drejtat e autorit.

- › *Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore.* Në lëndën e artit pamor zhvillohet në mënyrë kreative dhe edukative krijimi i punimeve që flasin për tema të tilla si: ruajtja e natyrës, ndotja e ajrit, e ujit dhe e tokës, ndryshimet klimatike, rëndësia e riciklimit dhe kursimit të energjisë, etj.
- › Pjesë e kësaj është edhe analiza e mesazhit që mbartin veprave të ndryshme artistike bashkëkohore me temë mbi qëndrueshmërinë mjedisore dhe problematikat e saj në ditët e sotme. Gjithashtu edhe organizimi i ekspozitave me temën bosht mjedisin ku kombinohen njohuritë artistike së bashku me idetë novatore të nxënësve për çështje të tilla.
- › *Teknologjia, shoqëria dhe media.* Arti pamor luan një rol të rëndësishëm për të zhvilluar te nxënësit aftësi kritike, kreative dhe digjitale në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur përmes teknologjisë. Teknologjia tashmë ofron mjete të reja shprehëse në krijim e po aq edhe në promovimin e artit pamor. Nxënësi mëson të përdorë programe të ndryshme digjitale (scetchbook, corel painter, photoshop, etj.), krijon kompozime origjinale përmes teknologjisë, analizon mjetet digjitale dhe mundësinë shprehëse të tyre. Mediat sociale, të përdorura në orientimin e duhur, shërbejnë si burim informacioni për krijimet të ndryshme në art, dizajn dhe artizanat. Këto media ndikojnë në formimin e preferencave artistike dhe estetike të nxënësve.
- › Gjithashtu nxënësi reflekton mbi etikën e përdorimit të veprave të artit dhe krijimeve të tij në rrjete sociale (e drejta e autorit, privatësia, etj.).

### 4.3 Kompetencat e lëndës “Art pamor” dhe aftësitë e shekullit XXI që zhvillohen përmes saj


Arti pamor nuk është vetëm një disiplinë artistike, por një mjet i fuqishëm për të zhvilluar aftësi kyçe të shekullit 21. Ai e përgatit nxënësin për të qenë *krijues, bashkëpunues, komunikues efektiv dhe qytetar aktiv* në një botë në zhvillim të vazhdueshëm. Aftësitë kyçe të shekullit 21, janë një grup kompetencash që i ndihmojnë individët të jenë të suksesshëm në një botë që ndryshon me shpejtësi, të drejtuar nga teknologjia, informacioni dhe globalizimi. Lënda e artit pamor, në mënyrë të natyrshme, kontribuon fuqishëm në zhvillimin e këtyre aftësive.

- **Kreativiteti**, ku arti pamor inkurajon dhe nxit krijimtarinë përmes gjuhës artistike, mjeteve dhe teknikave artistike, eksperimentit dhe interpretimit artistik të temave, ngjarjeve dhe ideve. Nxënësit mësojnë të shprehin veten në mënyrë unike dhe të zhvillojnë ide origjinale.
- **Bashkëpunimi**, ku arti pamor nxit nxënësit të punojnë në grup si p.sh.: në projekte të përbashkëta artistike dhe aktivitete ndërdisiplinore, etj., ku secili ka një rol të rëndësishëm. Kështu ju jepet mundësia që ata të punojnë në grup dhe të ndajnë dhe kuptojnë përgjegjësitë.
- **Komunikimi**, ku arti pamor si një formë pamore komunikimi – përçon ndjenja, mesazhe dhe histori. Gjithashtu, diskutimi mbi artin pamor ndihmon zhvillimin e të folurit dhe të shkruarit.
- **Mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve**, ku arti pamor inkurajon dhe nxit nxënësit në analizimin e veprave të artit, zhvillon aftësitë e vendimmarrjes gjatë interpretimit dhe zgjidhja e sfidave teknike, ideore dhe artistike ndihmojnë në zhvillimin e mendimit analitik.
- **Aftësitë teknologjike**, ku arti pamor inkurajon dhe nxit përdorimin e programeve digjitale artistike, të platformave online për krijim/shpërndarje të informacionit pamor duke zhvilluar aftësitë digjitale.
- **Ndërgjegjësimi global dhe kompetencat kulturore**, ku arti pamor jep mundësinë për njohjen dhe kuptimin e kulturave të ndryshme në klasë. Mësimi i artit pamor i ndihmon nxënësit të jenë më të hapur dhe të kuptojnë diversitetin kulturor.
- **Aftësitë për mësim gjatë gjithë jetës**, ku arti pamor kërkon përkushtim, durim dhe disiplinë – vlera që ndihmojnë në formimin e një qëndrimi pozitiv ndaj të nxënës të vazhdueshëm.

#### 4.4 Kompetencat e lëndës së artit pamor dhe rezultatet e të nxënës

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e artit pamor synon të përmbushë 3 kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 3 tematikave kryesore. Këto kompetenca zbërthehen në rezultate të nxënës për secilën klasë.

Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së artit pamor



**Tabela 2: Kompetencat e artit pamor dhe rezultatet e të nxënësve**

Gjithashtu lënda e artit pamor, zhvillon një sërë aftësish ku nxënësit angazhohen në veprimtari artistike dhe zhvillojnë kompetencat e lëndës.

Tre janë kompetencat këndore të artit pamor që përftohen nga njohuritë dhe përfshijnë:

KOMPETENCAT LËNDORE – ART PAMOR		
Kompetencat lëndore	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënësve për kompetencat për klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë
<b>Krijimi artistik</b>	<p><i>Nxënësi nëpërmjet kësaj kompetence zhvillon aftësitë krijuese duke përdorur gjuhën artistike pamore për të komunikuar idetë dhe i realizon ato përmes një shumëllojshmërie të teknikave artistike.</i></p> <p><i>Kjo kompetencë kërkon që nxënësit të zhvillojnë ide të reja krijuese, duke i ndarë ato me shokët e klasës, në shkollë, komunitet por edhe në ngjarje të ndryshme artistike.</i></p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon se si estetika reflektohet në jetën e përditshme;</li> <li>- diskuton mbi artin duke u nisur nga disa qëndrime estetike;</li> <li>- krijon punime arti dy dhe tre dimensionale nëpërmjet përdorimit të larmishëm të gjuhës pamore;</li> <li>- komunikon ide origjinale nëpërmjet krijimeve me teknika të larmishme;</li> <li>- analizon dhe organizon elementët dhe parimet e artit në krijim;</li> </ul>

	<p><i>Në përgjithësi, kompetenca e krijimit është thelbësore për suksesin në art pamor, pasi u mundëson nxënësve të kuptojnë gjuhën artistike pamore dhe ta përdorin atë si një mundësi për të komunikuar ide të reja.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon veprën e artit duke i ‘u referuar elementeve dhe parimeve;</li> <li>- analizon eksperiencat krijuese dhe identifikon se çfarë ka mësuar nga ato;</li> <li>- zbulon përmbajtjen e veprave të artit dhe analizon elementët e gjuhës pamore.</li> </ul>
<p><b>Realizimi i punimit</b></p>	<p><i>Nxënësi përmes kësaj kompetence zhvillon aftësinë për të realizuar punime artistike nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike. Zbulon mundësitë shprehëse të teknikave nëpërmjet eksperimentit dhe i përdor ato për të shprehur idetë e tij. Organizon gjuhën pamore në krijimet e tij nëpërmjet teknikave artistike dhe analizon eksperiencat krijuese.</i></p>	<p style="text-align: center;">Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdor me mjete, teknika dhe procese të larmishme artistike gjatë krijimit;</li> <li>- Demonstron aftësi krijuese gjatë realizimit të punimeve si nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra edhe nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës;</li> <li>- Demonstron aftësi në seleksionimin, përgatitjen dhe paraqitjen e punimit;</li> <li>- Analizon dhe organizon materialet, gjuhën pamore në krijimet e tij/saj origjinale;</li> <li>- Analizon eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit.</li> </ul>

		- Ndan përvojat e veta krijuese me të tjerë.
<b>Vlerësimi i veprave të artit</b>	<i>Nxënësi përmes kësaj kompetence zhvillon aftësinë për të përshkruar, analizuar, interpretuar dhe vlerësuar vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore në aspektin historik dhe social kulturor. Gjithashtu aftësohet të komunikojë emocionet dhe gjykimin e tij mbi vepra të ndryshme arti si dhe për punën e tij/saj dhe të shokut/shoqes. Identifikon dhe kategorizon veprat e artit sipas teknikës, periudhës, stilit dhe artistit. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësi/ja kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri, gjithashtu respekton opinione estetike dhe kritike të ndryshme. Nxënësi/ja diskuton rreth çështjeve dhe problemeve të artit sot.</i>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik;</li> <li>- Zhvillon aftësitë vlerësuese dhe kritike ndaj veprave të artit nëpërmjet mendimit estetik;</li> <li>- Identifikon dhe kategorizon veprat e artit sipas teknikës, periudhës, stilit dhe artistit;</li> <li>- Demonstron aftësi gjatë përshkrimit, analizës, interpretimit dhe vlerësimit të veprës së artit;</li> <li>- Tregon interes ndaj komenteve të të tjerëve;</li> <li>- Respekton shumëllojshmërinë e opinioneve estetike dhe kritike;</li> <li>- Diskuton rreth çështjeve dhe problemeve të artit sot.</li> </ul>

## 5 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

### 5.1 Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë

Lënda e artit pamor zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje të detyruar për 36 javë mësimore me nga 2 orë, pra gjithsej 72 orë. Programi i lëndës së artit pamor specifikon peshën (orët e sugjeruara) të secilës tematikë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuar në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

*Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë*

Tematika	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknika dhe procese artistike	Historia, arti dhe shoqëria	Gjithsej orë
<b>Klasa 10/11/12</b>	15	20	37	72 orë

## 5.2 Përmbajtja e lëndës sipas tematikave dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre

Programi i lëndës art pamor klasa e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë zhvillohet përmes tri tematikave: *Tematika I: Gjuha dhe komunikimi artistik, Tematika II: Teknika dhe procese artistike, Tematika III: Historia, arti dhe shoqëria.*

Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë, që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse, ndërkohë qëndrimet dhe vlerat që demonstroi nxënësi në lëndë e artit pamor përmbledhen për të gjitha tematikat. Tematikat dhe renditja e tyre **nuk** presupozojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave dhe në këtë renditje. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

### KLASA 10/11/12

#### 5.2.1 Tematikat: Gjuha dhe komunikimi artistik – Teknika dhe procese artistike – Historia, arti dhe shoqëria

##### TEMATIKA: GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

###### *Përshkrimi i tematikës*

Përmbajtja e kësaj tematike trajton se si estetika reflektohet në jetën e përditshme dhe se si përdoren elementët e gjuhës pamore për të realizuar idetë përmes imazheve. Përdorimi i hapave të procesit krijues që nga stimuli, ideja dhe realizimi nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike shërben për të rritur aftësitë krijuese. Prosesi i eksperimentit është pjesë e rëndësishme e krijimit artistik pasi ndihmon në aftësimin për të personalizuar tema e subjekte të ndryshme. Personalizimi i temave dhe subjekteve dhe përdorimi i qëllimshëm i elementeve të gjuhës artistike

është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit krijues. Gjithashtu eksperiencia krijuese dhe zbulimi i përmbajtjes së veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës pamore është pjesë e kësaj tematike.

NJOHURITË	AFTËSITË
<p><b>Estetika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Arti dhe studimi i artit; teoritë e artit; leximi i veprës së artit.</li> </ul> <p><b>Pika:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdorimi i pikës në komunikimin pamor.</li> </ul> <p><b>Vija:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Funkzioni shprehës i vijës në veprat e artit.</li> </ul> <p><b>Forma dy dhe tre dimensionale:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëdhënia midis formës dy dhe tre dimensionale. (Vëllimi në skulpturë, pikturë dhe arkitekturë)</li> </ul> <p><b>Ngjyrat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti i ngjyrave në veprat e artit. Vlera simbolike e ngjyrës.</li> </ul> <p><b>Tekstura:</b></p>	<p><i>Nxënësi demonstroi se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon se si estetika reflektohet në jetën e përditshme;</li> <li>- diskuton mbi artin duke u nisur nga disa qëndrime estetike;</li> <li>- identifikon arsyet përse njerëzit studiojnë art;</li> <li>- identifikon përdorimin e pikës në vepra të ndryshme të artit dhe dizajnit dhe e përdor për të komunikuar mendimin e tij personal;</li> <li>- studion funksionin shprehës të vijës në vepra të ndryshme artistike si në pikturë, skulpturë, arkitekturë, dizajn; - krijon duke përdorur mundësitë shprehëse të vijës;</li> <li>- identifikon dhe shqyrton kontrastin midis formës së nënkuptuar mbi sipërfaqen dy dimensionale dhe formës reale tre dimensionale; - përdor vëllimin në mënyrë krijuese dhe shprehëse duke u mbështetur në vepra të ndryshme arti;</li> <li>- zbulon mundësitë shprehëse të ngjyrës nëpërmjet studimit të veprave të artit; - zbulon vlerën simbolike dhe komunikuese të ngjyrës në kultura të ndryshme dhe në natyrë; - përdor ngjyrën në mënyrë krijuese dhe shprehëse duke u mbështetur në vepra të ndryshme arti;</li> </ul>

<p>- Llojet e teksturave në veprat e artit që karakterizojnë stilin e artistit</p> <p><b>Kompozimi:</b></p> <p>- Organizimi i elementëve të artit në një vepër (parimi i ekuilibrit, baraspesha).</p> <p><b>Hapësira:</b></p> <p>- Koncepti i hapësirës në periudha të ndryshme të historisë së artit.</p> <p><b>Proporcionet:</b></p> <p>- Trupi i njeriut dhe portreti.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shqyrton lloje të ndryshme teksturash duke zbuluar funksionin komunikues të saj në vepra të ndryshme arti; - përdor në mënyrë të qëllimshme teksturën për të komunikuar ide duke u mbështetur në vepra të ndryshme arti;</li> <li>- identifikon rregullat e kompozimit në veprat e artit dhe i përdor ato për tu shprehur në mënyrë personale; - shqyrton llojet e ndryshme të ekuilibrit (baraspesha) se si ato ndikojnë në kompozim dhe në perceptimin e veprës së artit;</li> <li>- identifikon, shqyrton dhe përdor konceptet e hapësirës në krijim;</li> <li>- përdor me efektivitet proporcionet e trupit të njeriut dhe portretit në krijim;</li> <li>- aplikon eksperimentimin me elementet dhe parimet e artit për të krijuar;</li> <li>- analizon veprat e artit, punën e tij dhe të shokut duke iu referuar elementeve dhe mënyrës së organizimit të tyre në krijim.</li> </ul>
---	---

## TEMATIKA: TEKNIKA DHE PROCESË ARTISTIKE

### *Përshkrimi i tematikës*

Përmbajtja e kësaj tematike mundëson në aftësimin e procesit të realizimit të punëve dy dhe tre dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike. Pjesë e kësaj tematike janë mundësitë shprehëse që ofrojnë teknikat e ndryshme artistike dhe mundësia e eksperimentit në realizimin e punimit. Një vend të rëndësishëm zë për zgjedhja e qëllimshme e teknikave artistike për të realizuar idenë dhe për të dhënë mesazhin për një audiencë të caktuar. Gjithashtu, mënyrat e ndryshme të organizimit të gjuhës pamore nëpërmjet teknikave të ndryshme artistike, ndarja e eksperiencave krijuese, e po ashtu edhe paraqitja dhe analiza e punimit duke respektuar larminë e shprehjeve artistike, janë pjesë e përmbajtjes së kësaj tematike.

NJOHURITË	AFTËSITË
<p><b>Vizatimi:</b> - Teknikat e vizatimit.</p> <p><b>Piktura:</b> Tehnikat e pikturës.</p> <p><b>Stampimi:</b> - Teknikat e stampimit.</p> <p><b>Fotografia:</b> - Fotografia digjitale. - Tehnika manuale të përpunimit të fotografisë. - Tehnika digjitale të përpunimit të fotografisë.</p> <p><b>Dizajni dhe prezantimi:</b> - Objekt dizajni (projektimi i objekteve) - Grafik dizajni</p> <p><b>Skulptura:</b> - Teknikat dhe përdorimet.</p> <p><b>Konstruksioni:</b> - Projektimi, urbanistika. - Skenografia.</p>	<p><i>Nxënësi demonstroi se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor metoda të ndryshme për të paraqitur hapësirën në vizatim (peizazh, natyrë e qetë, kompozim, etj.) si: mbivendosjen, detajet, perspektivën me një pikë, perspektivën me dy pika, etj;</li> <li>- përdor mjete dhe teknika të larmishme për të krijuar në vizatim si: lapsi, lapustilet, lapsat me ngjyra, pena dhe boja (rapidografi);</li> <li>- aplikon teksturën ose hijet nëpërmjet përdorimit të linjave si të kryqëzuara, të vijëzuara, të përziera, pikëzimeve, etj, në vizatim;</li> <li>- përdor figurën e njeriut në krijim; - përdor mjete, teknika dhe procese të ndryshme për të krijuar piktura që reflektojnë interesin, imagjinatën dhe idetë personale;</li> <li>- krijojnë duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (vlerën, intensitetin, kontrastin, etj);</li> <li>- demonstroi aftësi për të identifikuar karakteristikat e teknikave dhe proceseve të stampimit;</li> <li>- përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të stampimit për të realizuar idetë krijuese;</li> <li>- identifikon karakteristikat e fotografisë digjitale dhe marrëdhënien e saj me fotografinë tradicionale;</li> <li>- krijojnë kolazhe me fotografi ose përpunon imazhe fotografike me teknika manuale;</li> </ul>

- përdor teknologjinë për të përpunuar dhe manipuluar imazhe të ndryshme;
- krijon dizajnin e objekteve (të një produkti industrial ose artizanal);
- identifikon përdorimin e gjuhës pamore në dizajn dhe rëndësinë e saj në komunikimin e idesë;
- krijon dizajnin për paketimin e objekteve të ndryshme, logon, ose kopertinën e një libri;
- demonstroi aftësi për të krijuar në skulpturë nëpërmjet teknikave të gdhendjes, derdhjes, modelimit ose assemblazhit;
- përdor materiale të ndryshme për të krijuar në skulpturë (skulpturë e rrumbullakët, relief); shpjegon marrëdhënien midis formës dy dimensionale dhe asaj tre dimensionale në skulpturë;
- përdor materiale të riciklueshme për të krijuar konstrukcione banesash në miniaturë;
- analizon elementet urbanistikë të qytetit, simbolikën dhe funksionin e tyre;
- analizon skenografinë si një art i projektimit të skenës në teatër, në kinematografi e në televizion;
- projektonte dhe realizonte në miniaturë një skenë teatri ose spektakli;
- mban një bllok skicash dhe shënimesh të cilin e përdor si një burim informacioni;
- përdor teknikat artistike për të realizuar idetë në profesione të ndryshme si: dizajni i modës, arkitekti, grafik dizajni, fotografi, etj.
- për zgjedh krijimet më të mira për t'i prezantuar në portofolin e nxënësit.

## TEMATIKA: HISTORIA, ARTI DHE SHOQËRIA

### *Përshkrimi i tematikës*

Përmbajtja e kësaj tematike mundëson që nxënësi të aftësohet më tej në njohjen e historisë së artit pamor dhe zhvillimit të saj, sipas karakteristikave të periudhës, veprave dhe artistëve dhe zhvillimin e artit pamor nga fillimet e saj deri në ditë tona. Gjithashtu kjo tematikë përmban njohuri mbi analizën e veprave të ndryshme të artit dhe objekteve të dizajnit dhe trashëgimisë kulturore duke ndjekur hapat si: përshkrimi, analiza, interpretimi dhe vlerësimi në aspektin historik dhe social kulturor. Përmbajtja e kësaj tematike nxit komunikimin e emocioneve dhe gjykimin mbi vepra të ndryshme artit, por edhe komunikimin mbi krijimet personale. Duke iu referuar historisë së artit dhe kulturës, synohet pasurimi i perceptimit për mjedisin dhe njohja më e mirë e tij. Identifikimi dhe kategorizimi veprave të artit sipas teknikës, periudhës, stilit dhe artistit. Nëpërmjet kësaj tematike merr rëndësi roli i artit pamor dhe artistit në shoqëri, gjithashtu nxitet respektimi i opinionëve estetike dhe kritike të ndryshme dhe diskutimi rreth çështjeve rreth çështjeve dhe problemeve të artit sot.

NJOHURITË	AFTËSITË
<p><b>Histori arti:</b></p> <p>- Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme; objekte nga trashëgimia kulturore.</p> <p>(Prehistoria; Arti Egjiptian; Antikiteti [Arti Grek dhe Romak]; Arti në mesjetë; Rilindja; Baroku; Neoklasicizmi; Romantizmi; Realizmi; Arti në Lindje;</p>	<p><i>Nxënësi demonstroi se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon veprat e artit dhe zhvillimet artistike në lidhje me periudhën historike dhe vendin;</li> <li>- diskuton ose shkruan rreth historisë së artit duke përdorur një fjalor të zgjeruar artistik;</li> <li>- shqyrton veprat e artit në kontekstin e tyre historik duke i lidhur me ngjarjet historike;</li> </ul>

<p>Impresionizmi; Postim presionizmi' Arti në shek. XX; Arti dhe dizajni sot; Historia e artit Shqiptar<sup>2</sup>).</p> <p><b>Eksperiencia artistike:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vizita në studiot e artistëve, punishtet e artizanëve të zonës.</li> <li>- Takime me artistë, dizajnë, artizanë, arkitektë etj.</li> </ul> <p><b>Ekspozita dhe evente kulturore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet.</li> <li>- Vizita në muzeume, (arkeologji, etnografi) galeri arti, qendra kulturore, site arkeologjike, objekte të trashëgimisë kulturore, etj.</li> </ul> <p><b>Media:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit në periudha historike dhe në kontekste kulturore të ndryshme;</li> <li>- diskuton kushtet sociale që ndikuan veprat e artit;</li> <li>- përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe nga kultura të tjera, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;</li> <li>- përshkruan simbolet në veprat e artit në lidhje me kontekstin historik;</li> <li>- analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti;</li> <li>- argumenton dhe komunikon mendimin e tij mbi veprën;</li> <li>- diskuton dhe respekton mendimin e tjetrit;</li> <li>- zbulon një spektër të gjerë të karrierës në artet pamore; - viziton muze, galeri, qendrën kulturore, site arkeologjike, etj;</li> <li>- merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë e komunitet;</li> <li>- përdor burime të ndryshme informacioni;</li> <li>- prezanton informacionin e mbledhur rreth veprave të artit dhe autorëve të tyre;</li> <li>- analizon dhe prezanton informacionin e mbledhur rreth objekteve të artizanatit dhe trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.</li> </ul>
---	---

<sup>2</sup> Historia e artit shqiptar është mirë të integrohet përgjatë zhvillimit kronologjik të periudhave historike të artit botëror.

- Libra, revista, postera, filma, aparat fotografik, kompjuter, etj.

## QËNDRIME DHE VLERA

Nxënësi:

- Zhvillon qëndrim pozitiv ndaj të mësuarit të artit pamor duke nxitur kureshtjen, dëshirën për të zbuluar dhe eksploruar vepra të ndryshme artistike.
- Krijon vetëbesim dhe vetëvlerësim duke i bërë ata të ndihen të sigurt për aftësitë e tyre për t'u shprehur në artin pamor.
- Zhvillon durimin dhe përqendrimin, vëmendjen dhe këmbënguljen nëpërmjet procesit të punës për realizimin e punimeve artistike .
- Përfshihet aktivisht dhe mëson të marrë pjesë me dëshirë në veprimtaritë krijuese dhe bashkëpunuese në klasë dhe në shkollë.
- Krijon ndjenjën e bashkëpunimit dhe punës në grup gjatë zhvillimit të projekteve artistike , duke nxitur ndjesinë e përkatësisë dhe përgjegjësisë kolektive.
- Stimulon imagjinatën për të shprehur ndjenjat dhe idetë në mënyrë artistike përmes krijimeve në art pamor.
- Zhvillon aftësitë vëzhguese për të zbuluar karakteristikat e veprave të artit dhe dizajnit, objekteve të trashëgimisë kulturore dhe artizanatit.
- Vlerëson dhe respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe atë të kulturave të tjera.
- Mbështet me argument mendimin dhe gjykimin personal dhe respekton mendimin e të tjerëve.

### 5.3 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve)<sup>3</sup>.

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të veprimtarive që mund të përdoren nga mësuesi për përmbushjen e rezultateve të të nxënit në tematika të ndryshme.

*Tabela 4. Shembull i veprimtarive për përmbushjen e RN-ve*

REZULTAT TË NXËNI TË ORËS MËSIMORE	VEPRIMTARIA PRAKTIKE
<b>SHEMBULLI</b>	
<p>Shpjegon Mësuesi/ja shpjegon se në teatër, ndihet një raport shumë i ngushtë midis fushave të ndryshme të shprehjes artistike. Teatri përbëhet nga dy hapësira. Në</p>	<p><b><i>Prezantimi i situatës</i></b>  Mësuesi prezanton situatën problemore me ndihmën e imazheve që ilustrojnë skena nga pjesë teatrale dhe skena nga shfaqje/spektakle të tjera. Synimi është që nxënësit të vëzhgojnë dhe të identifikojnë komponentët e skenës dhe funksionin e tyre në shfaqje teatrale apo shfaqje, spektakle të tjera.  Bën pyetje të hapura:</p>

<sup>3</sup> Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e artit pamor do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit sipas tematikave të lëndës.

hapësirën e skenës ndërtohet edhe skenografia.

- Si shfaqet skena në një pjesë teatrale në lidhje me funksionin e saj dhe si shfaqet ajo në një shfaqje spektakli?
- A mund të identifikoni komponentët skenikë dhe t'i rendisni ato?
- Çfarë materialesh janë përdorur për realizimin e këtyre komponentëve?

Nxënësit ndahen në 3–4 grupe dhe secili grup:


- Zgjedh pjesën skenike që do të realizojë
- Diskutojnë mbi elementet përbërës të skenës dhe funksionin e tyre
- Ndajnë punën në grup sipas aftësive përkatëse
- Realizon skic-idetë për mocketin e skenës

Çdo grup realizon mocketin dhe kostumet e skenës sipas tematikës së zgjedhur (teatër apo spektakël me një temë të caktuar). Pas përfundimit të mocketit përgatiten për prezantim.

Çdo grup prezanton punën e vet dhe nxënësit bëjnë pyetje. Mësuesi udhëheq diskutimin për të nxjerrë përfundimin mbi:

mënyrën e realizimit të skenës dhe për karakteristikat e saj në lidhje me shfaqjen. Elementet përbërës të skenës dhe funksioni n e tyre.

Diagrama 3. Shembull situatë të nxëni dhe lidhja me elementet e programit



## 6 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Mësimdhënia dhe të nxënit efektiv përfshin një kombinim qasjesh, strategjish, metodash dhe teknikash që përdoren për të mbështetur të nxënit efektiv dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve në mjediset mësimore. Këto strategji dhe metoda manin parasysh dhe plotësojnë nevojat e të nxënit si dhe sigurojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe shfrytëzimin e informacionit, duke nxitur përgjegjshmërinë vetjake, iniciativën, reflektimin, pavarësinë e gjykimit, vetëvlerësimin, bashkëpunimin dhe barazinë. Edukimi promovon disa metoda të nxëni të cilat janë: a) Të nxënit me në qendër nxënësin; b) Të nxënit që promovon kompetencat; c) Të nxënit e diferencuar; d) Të nxënit e integruar; dh) Përdorimi i teknologjisë digjitale; e) Mësimin e kombinuar; ë) Të nxënit e bazuar në projekte; f) Angazhimi aktiv; g) Zhvillimin e të menduarit kritik dhe zgjedhjes së problemeve; gj) Të nxënit në bashkëpunim; h) Të nxënit e bazuar në krijime, etj.

### 6.1 Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e artit pamor.

**Metoda mësimore** në lëndën e artit pamor janë:

Zhvillimi i ndjeshmërisë estetike dhe emocionale përmes vëzhgimit të veprave të artit dhe dizajnit.

- *Nxënësit mësojnë të vlerësojnë bukurinë dhe funksionin e artit pamor, dizajnit dhe ndikimin e tyre shoqëri.*

Formimi i kulturës pamore përmes njohjes së historisë së artit, veprave të artistëve përfaqësues kombëtarë e botërorë.

- *Nxitja e vlerësimit për trashëgiminë në artet pamore shqiptare dhe të popujve të tjerë.*

Zhvillimi i aftësive për të përshkruar, analizuar dhe vlerësuar artin pamor, dizajnin dhe elemente të trashëgimisë kulturore.

- *Përdorimi i hapave të analizës kritike për të kuptuar dhe lexuar veprat e artit dhe dizajnit.*

Zhvillimi i aftësive për të përdorur dhe komunikuar përmes gjuhës pamore.

- *Përdorimi i elementeve dhe parimeve thartit pamor për të shprehur ide dhe mendime nëpërmjet punimeve artistike.*

Nxitja e krijimtarisë artistike dhe shprehjes personale përmes përdorimit dhe eksperimentimit me teknika të larmishme artistike.

- *Përfshirja e nxënësve në krijime artistike 2 dhe 3 dimensionale, duke përdorur dhe eksperimentuar me teknika të ndryshme artistike.*

Forcimi i bashkëpunimit dhe komunikimit përmes aktiviteteve/projekteve artistike në grup.

- *Puna në projekte të përbashkëta artistike që zhvillojnë frymën e grupit dhe përgjegjësinë e ndërsjellë.*

Ndërtimi i qëndrimeve pozitive ndaj mësimit të artit pamor dhe përfshirjes në jetën kulturore.

- *Inkurajimi për pjesëmarrje në aktivitete artistike dhe vlerësimi i artit si pjesë e rëndësishme e jetës shoqërore.*

## 6.2 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e artit pamor

**Mësimi i artit pamor** me *persona me nevoja të veçanta* kërkon strategji të veçanta të mësimdhënies dhe një qasje të personalizuar, të ndjeshme dhe të mbështetur në metoda fleksibël e kreative. Ja disa metoda mësimi të rekomanduara, të shoqëruara me strategji praktike që mund të zbatohen në klasë. Disa nga metodat dhe qasjet që mësuesi mund të zhvillojë në klasë për personat me nevoja të veçanta janë:

### A. Mjetet dhe teknikat artistike

- › Përshkrimi: Bazohet në përdorimin e teknikave artistike dy dhe tre dimensionale si nxitje për krijim
- › E përshtatshme: për të riun me spektrin e autizmit apo çrregullime të të nxënit.
- › Një model: I riu përdor mjetet si bojërat e ujit dhe penelat; procese si, prerje ngjitjet; teknika të thjeshta stampimi; modelim me plastelinë, etj., në varësi të specifikave, dëshirave dhe mundësive.

### B. Veprat e artit për referim dhe nxitje

- › Përshkrimi: Përdor vepra arti me figuracione të thjeshta, si referencë.
- › E përshtatshme: për të riun me probleme të përqendrimit.
- › Një model: Mësuesi përdor vepra arti për të ndihmuar nxënësin të dallojë figuracione të ndryshme dhe t'i përdorë në krijim si modele për t'i interpretuar.

### C. Ndërveprimi individual dhe i vogël në grup

- › Përshkrimi: Mësimi zhvillohet në grupe të vogla ose në mënyrë individuale.

- › E përshtatshme: sepse lehtëson ndjekjen e procesit të punës, duke respektuar vështirësitë e tij.
- › Një model: Ndarja e punës sipas aftësive dhe ndihma reciproke.

### 6.3 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e artit pamor

**Mësimi i artit pamor** për të riun *e talentuar* kërkon strategji të veçanta të mësimdhënies. Këto strategji kërkojnë nga mësuesi të përgatisë materiale të diferencuara për këta të rinj p.sh.: kërkesa më të larta në kompozimin dhe përdorimin e elementeve dhe parimeve të artit; eksperimentimin me teknikat artistike për të dalë në përfundime personale; përdorimin e teknikave të duhura për të vënë më në pah idenë apo mesazhin e në krijim; Inkurajimin e nxënësve në hulumtimin artistik dhe në realizimin e ideve nëpërmjet teknikave artistike të shumëllojshme; Njohjen e artistëve dhe krijimet e tyre në kontekste të ndryshme historike dhe kulturore. Inkurajimi për të zhvilluar aftësitë analitike për të analizuar veprat e artit nga periudha të ndryshme historike dhe bashkëkohore. Etj.

## 7 VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në mësimin e artit pamor, vlerësimi i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë është pjesë shumë e rëndësishme e procesit mësimor dhe ndihmon mësuesin të kuptojë se sa mirë po i përvetësojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë që lidhen me kompetencat e kësaj lënde. Në lëndën e artit pamor qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm vendosja e një note, por:

- t'i japë nxënësit mundësi të kuptojë progresin e tij, të mësojë nga gabimet duke reflektuar të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë, si dhe të motivohet për të ecur përpara;
- të ndihmojë mësuesin të kuptojë sa mirë nxënësit se sa i kanë kuptuar koncepte dhe po i zbatojnë ato;
- të ndihmojë mësuesin të përmirësojë mënyrën e mësimdhënies;

### 7.1 Llojet e vlerësimit në lëndën e artit pamor

#### *Vlerësimi diagnostikues (vlerësimi si proces të nxëni)*

Ky lloj vlerësimi bëhet në fillim të vitit shkollor. Mësuesi zbulon njohuritë që nxënësi ka dhe identifikon çfarë ka nevojë të përsëritet ose të mësohet më mirë. Ky vlerësim ndihmon mësuesin të planifikojë më mirë mësimin, duke përshtatur ritmin dhe mënyrat e punës me nevojat e nxënësve.

Ky vlerësim mund të realizohet:

- ✓ me pyetje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta;
- ✓ me ushtrime të shkurtra orientuese;
- ✓ me kuice të shkurtra;

- ✓ me biseda reflektuese,
- ✓ fisha vetëvlerësimi,
- ✓ ese etj.

### ***Vlerësimi formues (vlerësimi i vazhduar, vlerësimi për të nxënë)***

Ky vlerësim bëhet gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo mësim, për të parë si po ecin nxënësit. Ai ndihmon nxënësit dhe mësuesin të kuptojnë nëse janë në rrugën e duhur dhe çfarë duhet përmirësuar në punën e tyre para se të arrijnë vlerësimin përmbledhës ose përfundimtar.

Teknika të vlerësimit formues janë:

- ✓ vlerësimi i punës në grupe;
- ✓ vëzhgimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes gjatë mësimit;
- ✓ detyrat e përditshme dhe projektet e vogla;
- ✓ vlerësimi i diskutimeve dhe argumentimi i zgjidhjeve;
- ✓ vlerësimi i përgjigjeve gjatë mësimit;
- ✓ vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët, etj.

### ***Vlerësimi përmbledhës (vlerësimi periodik, vlerësimi i të nxënit)***

Ky vlerësim bëhet pas një periudhe mësimore dhe mat atë që nxënësi ka arritur të mësojë. Mund të realizohet me detyra individuale me shkrim, konkurse, detyra përmbledhëse dhe projekte përmblyllëse. Kjo zakonisht shoqërohet me notë dhe ndihmon mësuesin, nxënësin dhe prindërit të kuptojnë progresin dhe arritjet.

## 7.2 Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit në lëndën e artit pamor

- Vlerësimi duhet të ndihmojë nxënësit të mësojnë më mirë, të kuptojnë dhe të reflektojnë mbi gabimet e tyre.
- Detyrat dhe pyetjet e vlerësimit duhet të matin aftësitë dhe njohuritë që nxënësit duhet të zhvillojnë sipas kompetencave pamore.
- Vlerësimi duhet të jetë i qartë dhe i drejtë për të gjithë nxënësit, pavarësisht aftësive të tyre.
- Vlerësimi duhet të inkurajojë nxënësit të besojnë në vetvete dhe të kuptojnë që gabimi është pjesë e të nxënit.
- Mësuesi duhet të përdorë shumë forma vlerësimi, si: përgjigjet me gojë, ushtrimet, punën me materiale konkrete, projektet, vizatimet, punën në grup, detyrat e shtëpisë etj.
- Ky proces ndihmon që vlerësimi të bëhet një mjet i dobishëm dhe i kuptueshëm për të gjithë, jo vetëm një "kontroll" për nota, por një mënyrë për të ndihmuar nxënësit të rriten dhe të përmirësohen në mësimin e artit pamor.

## 7.3 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.

Mësuesi ndërton një sërë instrumentesh për vlerësimin e nxënësit në art pamor duke iu referuar specifikave të lëndës. *Instrumentet e vlerësimit* janë të domosdoshëm për të marrë informacion lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive pamore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. Vlerësimi i nxënësve në lëndën e **artit pamor** duhet të jetë **i matshëm**, duke përfshirë tregues jo vetëm për njohuritë teorike, por edhe shkathtësitë praktike, krijimin, përdorimin e teknikave, vlerësimin e veprave të artit dhe sjelljen gjatë aktiviteteve artistike.

*Tabela 5. Shembull për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve*

<b>Shembull:</b> <b>-Rezultati i të nxënit (RN): Nxënësi realizon punë dy dhe tre dimensionale nëpërmjet përdorimit të teknikave artistike dhe organizimit të elementeve të artit.</b>			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
- Nxënësi realizon në mënyrë të pavarur punë dy dhe tre dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike dhe organizimit të elementëve.	- Nxënësi realizon punë dy dhe tre dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme artistike dhe organizimit të elementëve duke ndjekur hapat e procesit krijues.	- Nxënësi realizon punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të thjeshta dhe modeleve të gatshme të organizimit të elementëve.	- Nxënësi ka vështirësi në realizimin e punimeve dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn edhe nëpërmjet përdorimit të teknikave të thjeshta dhe modeleve të gatshme të organizimit të elementëve.

## 8 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Gjatë procesit mësimor të artit pamor, përdorimi i burimeve dhe materialeve të ndryshme ndihmon në ndërtimin e një kuptimi të thellë dhe praktik të koncepteve artistike. Materialet konkrete, vizuale por edhe teknologjike krijojnë mundësi që nxënësit të mësojnë në mënyrë aktive, duke vëzhguar dhe zbatuar njohuritë pamore në situata reale. Mësuesi ka mundësinë të integrojë mjete të ndryshme për të bërë mësimin sa më të qartë dhe të aksesueshëm për të gjithë nxënësit, si:

- ✚ *materiale vizuale*: vepra arti, imazhe fotografike në lidhje me temën, postera, etj.;
- ✚ *objekte reale*: mjete të ndryshme artistike dhe objekte reale në lidhje me temën mësimore;
- ✚ *mjete teknologjike*: projektorë, kompjuterë, tableta, apo platforma mësimore online.

Gjatë shpjegimit, mësuesi përdor gjuhë të qartë dhe një fjalor të përshtatur për moshën dhe nivelin e nxënësve. Ai/ajo zgjedh shembuj konkretë dhe ushtrime të personalizuar, duke siguruar mbështetje shtesë për nxënësit që kanë nevojë.

## 8.1 Përdorimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale

Përdorimi i teknologjisë ndihmon në zhvillimin e aftësive digjitale që janë thelbësore në shekullin XXI. Arti pamor, nuk është vetëm art, por është edhe një mjet i fuqishëm edukimi që ndihmon në përgatitjen e individëve për sfidat dhe mundësitë e botës moderne. Integrimi i artit pamor dhe dizajnit me teknologjinë ka ndikuar në forma dhe mjete të reja të krijimit por edhe të përdorimit, shpërndarjes dhe të promovimit në shekullin XXI. Aftësitë teknologjike zhvillohen edhe në lëndën e artit pamor duke zhvilluar kompetencat lëndore në një dimension të ri.

Integrimi i teknologjisë në dhënien e informacionit dhe përdorimi i aplikacioneve dhe programeve ofrojnë mundësi për krijimtari dhe për ta bërë mësimin më tërheqës për nxënësit.

Disa platforma aplikative u mundësojnë nxënësve të krijojnë duke përdorur mjetet digjitale. Mësuesit gjithashtu mund të përdorin teknologji audio-vizuale për të bërë mësimet më tërheqëse dhe për të ndjekur progresin e nxënësve.

## 9 REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i programit të lëndës së artit pamor bazohet në Kornizën Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë, Planin Mësimor të Arsimit të Mesë të Lartë, si dhe në rekomandimet më të fundit të Bashkimit Evropian për arsimin. Si i tillë ky dokument i shërben mësuesve, vlerësuesve të jashtëm të cilësisë, prindërve, nxënësve. Në këtë rubrikë përshkruhen disa rekomandime për zbatuesit e programit në mënyrë që të zhvillohet me efektivitet programi i lëndës së artit pamor.

### a) *Rekomandime për mësuesit*

- ✓ Të lidhin përmbajtjen e artit pamor me lëndë të tjera (gjeografi, gjuhë, histori, muzikë, edukatë qytetare, TIK, etj.) për të ndihmuar kuptimin e thelluar dhe zbatimin praktik të koncepteve dhe për të kuptuar profesione të ndryshme.
- ✓ Të krijojnë aktivitete praktike që e ndihmojnë nxënësin të kuptojë përdorimin e artit pamor në jetën e përditshme dhe lidhjen e saj me profesione të ndryshme.
- ✓ Të planifikojnë mësimin duke respektuar ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për fëmijët me aftësi me talente.
- ✓ Të nxisin mjedisin bashkëpunues, të sigurt, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin socio - emocional.
- ✓ Të sigurojnë akses të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë ata nga pakicat kombëtare dhe grupe të marginalizuara.
- ✓ Të sigurojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të artit pamor (p.sh. sugjerohet 40% teori — 60% praktikë). Përdorimi praktik i artit pamor do të realizohet përgjatë çdo ore mësimore. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së teksteve shkollore.
- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin udhëzuesit kurrikularë të lëndës së artit pamor.
- ✓ Të përdorin materialet burimore për zbatimin e programit.

### b) *Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm*

- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për cilësinë e mësimdhënies në zbatim të programit dhe rubrikave të këtij programi.
- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e koncepteve pamore.
- ✓ Të vlerësojnë përdorimin e niveleve të arritjes për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve.
- ✓ Të vlerësojnë organizimin e punës në grupe dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mësimore.
- ✓ Të vlerësojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të artit pamor gjatë zhvillimit të orëve mësimore.
- ✓ Të nxisin mësuesit që të krijojnë mjedise të përshtatshme për personalizimin e të nxënësve dhe për mbështetjen e diversitetit në klasë.
- ✓ Të vlerësojnë se si mësuesit promovojnë mirëqenien socio - emocionale të nxënësve përmes mënyrës së komunikimit dhe aktiviteteve në orën e artit pamor.
- ✓ Të vlerësojnë që mësuesit garantojnë qasje të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet vulnerabel.

**c) Rekomandime për prindërit**

- Të inkurajojnë të rinjtë që të kuptojnë rëndësinë e artit pamor jo vetëm për notë, por për jetën e përditshme.
- Të sigurojnë që të rinjtë të ndihen të mbështetur emocionalisht dhe që mësimi i artit pamor zhvillohet në një atmosferë të qetë dhe motivuese për fëmijët e tyre.

**d) Rekomandime për nxënësit**

- ✓ Të marrin pjesë aktive në orët e artit pamor, duke kërkuar të kuptojnë përdorimin praktik të njohurive në këtë lëndë.
- ✓ Të bashkëpunojnë me shokët si në klasë ashtu edhe jashtë saj.
- ✓ Të jenë kureshtarë dhe të kërkojnë ndihmë kur hasin vështirësi, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve digjitale dhe burimet online.
- ✓ Të kuptojnë rëndësinë e artit pamor si bazë për profesione të ndryshme dhe të eksplorojnë interesat personale në këtë drejtim.

## 10 NDRYSHIMET PËRMBAJTJESORE

Në lëndën e arti pamor të klasës së dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë ka këto ndryshime përmbajtësore:

- 1) Vendosija e fokusit në situatat e veprimtarive praktike të të nxënimit duke sugjeruar një ndarje 40% pjesa teorike dhe 60% pjesa praktike. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
- 2) Përditësimi i kompetencave kyçe, dhe i rezultateve të të nxënimit të përshtatura për klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë .
- 3) Përditësimi i kompetencave të lëndës së artit pamor dhe i rezultateve të të nxënimit të përshtatura për klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë .
- 4) Përditësimi i temave ndërkurrikulare.
- 5) Përditësimi i metodologjisë me fokus të shtuar në zhvillimin e mendimit kritik, krijues zgjidhjen problemore si dhe duke përfshirë të nxënimit e personalizuar, të nxënimit socio emocional, përdorimin e teknologjisë etj.
- 6) Përditësimi i vlerësimit të nxënimit bazuar në nivelet e arritjes sipas rezultateve të të nxënimit.